

EDHE NE MERITOJMË LIBERALIZIM TË VIZAVE

Ne, Gratë e parashtrimit të kërkesës së mëposhtme, të cilat na lidhi momenti i hidhur historik për t'iu kundërvënë katër luftërave të përgjakshme të viteve të 90-ta në këtë pjesë të Ballkanit, lufta që lanë pas veti numrin më të madh të viktimave pas Luftës së Dytë botërore në këtë pjesë të Evropës:

- Themeluese të Lobit Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Europën Juglindore, që angazhohemi për forcimin dhe ndërtimin e paqes, të respektimit të vlerave të komuniteteve me kultura të ndryshme,
- Të bashkuara për të dhënë kontributin tonë në tejkalimin e pasojave të luftërave dhe në afrimin e popujve të kësaj pjesë të Ballkanit, përkundër faktit se në mesin tonë ka edhe gra që humben anëtarët më të dashur të familjeve, madje edhe gjysmën e familjes;
- Të angazhuara për mbështetjen e pajtimit në mes të popujve të kësaj pjesë të Ballkanit për hirë të krijimit të një ardhmërie të barabartë, pa diskriminime, për të gjithë popujt e Ballkanit Përendimor dhe në gjithë rajonin e Europës Juglindore;
- Jemi duke përjetuar rëndë politikën dhe vendimin diskriminues të BE-së për lënien e Kosovës, Shqipërisë dhe Bosne e Hercegovinës në “listën e zezë” të Shengenit dhe aplikimin e liberalizimit të vizave ndaj Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi,
- Jemi të zhgënjyera për faktin se jemi në momentin kur vendet e Europës Juglindore janë duke shkuar kah ndërtimi i marrëdhënieve të forta me Bashkimin European dhe NATO-n dhe kur këto tri shtete kanë bërë përparime evidente në procesin e integriteteve evropiane,

Të befasuara që, përkundër faktit se ishim viktimat e luftës, u “dënuam” me getoizim brenda kufijve të shteteve tona, ndonëse Bashkësia Evropiane ka vendosur Misionin e vet në Kosovë dhe në njëfarë mënyre është e pranishme edhe në Shqipëri dhe Bosne e Hercegovinë dhe është në pozitë që t'i vërej dhe prek të gjitha përparimet e arritura;

Unanimisht dhe urgjentisht kërkojmë nga Bashkësia Evropiane që:

- **Ta ndryshojë qëndrimin e vet diskriminues ndaj Kosovës, Shqipërisë dhe Bosne e Hercegovinës lidhur me liberalizimin e vizave për vendet e Shengenit;**

- Të promovojë trajtimin e barabartë dhe të praktikojë paanshmërinë në marrjen e vendimeve lidhur me lëvizjen e lirë të njerësve në vendet e Shëngenit,
- Ta rishikojë vendimin e vet për mospërfshirjen e Kosovës, Shqipërisë dhe të Bosne e Hercegovinës në sistemin e liberalizimit të vizave; dhe
- Ta zgjërojë listën e shteteve për liberalizimin e vizave edhe me Kosovën, Shqipërinë dhe Bosne e Hercegovinën.

Këtë kërkesë e konsiderojmë të drejtë dhe legjitime, andaj presim që të miratohet në afatin sa më të shkurtër.

Priahtinë, më 23 korrik 2009